

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas vdekjes së Dolly Parton plas sherri për trashëgiminë saj, menaxheri akuzon nipin e këngëtares për k ërcënime
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/pas-s-se-dolly-parton-plas-sherri-per-trashegimine-saj-menaxheri-i588029
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 07:03:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 07:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ad29b3a54289fb25383841b1210f052e007cb942a4b371a5b6631a265634f548
TEKSTI	92eef56cf68c61f6a87abe6e909ecf4b878d8749ea2da3ab4994b3c48ab65521
PAMJA	8cb17246728fa3f4478b34a2e0a76a26ba7f1d72754a2fa8cf294c9a6fade422

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	41ae9d9ad6c11de58734d69391f419cd8117a270cfe5ade78c1ea54cf2912270
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1057a6098f5231b1a7fb769cdeef6f94e5e01b8f35ccfb6287a805b5f635f739
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/41ae9d9ad6c11de58734d69391f419cd8117a270cfe5ade78c1ea54cf2912270

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



ie Trump u kthzoi aksesin, gjykata urdheron rikthimin e menjehershem te aksesit per CNN, MS NOW dhe PoliticoPas vdekjes se Dolly Parton plas sherri per trashegimin e fundit

Pas vdekjes së Dolly Parton plas sherri për trashëgiminë saj, menaxheri akuzon nipin e këngëtares për kërcënime



24 Shtator 2026, 09:00Lifestyle TEMA



Vetëm pak javë pas vdekjes së legendës së muzikës country, Dolly Parton, një konflikt i fortë ka shpërthyer mes njerëzve që menaxhojnë trashëgiminë e saj dhe nipit e 80-vjeçares, Bryan Seaver.

Kompania që administron bizneset dhe pronat e këngëtares e akuzon Seaver për kërcënime, frikësim dhe presion, ndërsa ka kërkuar nga gjykata një urdhër të përkohshëm kufizimi ndaj tij.

Bryan Seaver është djali i motrës së Dolly Parton, Cassie, dhe për rreth 20 vjet ka qenë përgjegjës për sigurinë e këngëtares. Ishte pikërisht ai që, me kërkesë të vetë Parton, njoftoi publikisht vdekjen e saj më 25 gusht.

Por marrëdhëniet mes Seaver dhe kompanisë “She’s Alive”, e drejtuar nga menaxheri shumëvjeçar i këngëtares Danny Nozell, janë përkeqësuar ndjeshëm. Javën e kaluar, Seaver dhe kompania e tij e sigurisë u pushuan nga detyra. Tashmë “She’s Alive” i është drejtuar gjykatës në Nashville duke pretenduar se Seaver ka zhvilluar një fushatë kërcënimesh ndaj personave që menaxhojnë interesat e këngëtares.

Në dokumentet gjyqësore pretendohet se Seaver ka kërcënuar se do të dëmtonte markën dhe partneritetet e krijuara nga Dolly Parton nëse nuk paguhej. Në një prej mesazheve të përfshira në dosje, ai pretendohet se ka paralajmëruar se do të krijonte një podcast për të dëmtuar partneritetet e markës së këngëtares.

Akuza edhe më të forta lidhen me të kaluarën e Seaver si kontraktor ushtarak. Sipas dokumenteve të paraqitura në gjykatë, ai dyshohet se ka përdorur eksperiencën e tij dhe referencat ndaj armëve e dhunës për të frikësuar punonjës dhe persona të lidhur me pasurinë e Parton. Kompania pretendon se situata ka bërë që disa persona të largohen nga puna dhe ka detyruar drejtuesit të marrin masa shtesë sigurie.

Bryan Seaver i mohon akuzat. Ai ka deklaruar se mesazhet dhe komunikimet e përdorura kundër tij janë nxjerrë jashtë kontekstit dhe se nuk bëhej fjalë për kërcënime. Sipas tij, disa prej bisedave ishin komunikime private të zhvilluara në një periudhë të rëndë emocionalisht pas humbjes së Dolly Parton.

Përplasja hap tashmë një betejë publike për trashëgiminë dhe interesat e biznesit të një prej emrave më të mëdhenj të muzikës amerikane. Para vdekjes,

Parton kishte punuar me ekipin e saj për të përcaktuar projektet dhe mënyrën se si do të vazhdonte trashëgimia e saj artistike dhe e biznesit edhe në dekadat e ardhshme.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[15 vite burg për Harvey Weinstein, ish-producenti i Hollywood-it dënohet për sulmin seksual ndaj asistentes në 2006-ën](#)

22:55 Lifestyle / 1 koment

Miliarderët po kërkojnë mënyra për të jetuar përgjithmonë, fizikani i njohur: Është humbje kohe

17:00 Lifestyle / 3 komente

[FOTO/ Këngëtarja shqiptare nuk kursehet me pozat provokuese, shfaqet me bikini minimaliste](#)

15:55 Lifestyle / 6 komente

[“Nuk kam më jetë”, aktori francez vdes në moshën 43-vjeçare pas eutanazisë në Belgjikë](#)

14:48 Lifestyle  9 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.